

20211031633

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIMIN PENSIONAL**  
**VULLNETAR ME FINANCIM KAPITAL**

Neni 1

Në Ligjin për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/08, 124/10, 17/11 dhe 13/13), në nenin 4 në paragrafin (1) pas pikës 24 shtohet pikë e re 25, si vijon:

“25. “Person përgjegjës” për kundërvajtje është:

- anëtari i Këshillit drejtues dhe/ose anëtari i Këshillit mbikëqyrës të shoqërisë apo person i autorizuar prej tij,
- drejtori apo udhëheqësi i njësisë organizative përgjegjës për ruajtje të pronës së rojtarit të pronës apo personi i autorizuar prej tij,
- drejtori i Qendrës për kuotim apo personi i autorizuar prej tij,
- anëtari i organit për menaxhim dhe/ose anëtari i organit mbikëqyrës të personit juridik që parashtron dokumente në procedurën për licencim apo personi i autorizuar prej tij.”

Neni 2

Në nenin 29 në paragrafin (1) fjalët: “person udhëheqës” zëvendësohen me fjalët: ”person përgjegjës për: vendimet investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përlllogaritje të tërheqjeve të programuara”.

Neni 3

Në nenin 30 në paragrafin (1) fjalët: “person udhëheqës” zëvendësohen me fjalët: ”person përgjegjës për: vendimet investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përlllogaritje të tërheqjeve të programuara”.

Neni 4

Në nenin 30 në paragrafin (1) fjalët: “person udhëheqës” zëvendësohen me fjalët: ”person përgjegjës për: vendimet investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përlllogaritje të tërheqjeve të programuara”.

Në paragrafin (2) fjalët: “person udhëheqës” zëvendësohen me fjalët: ”person përgjegjës për: vendimet investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përlllogaritje të tërheqjeve të programuara”.

Neni 5

Në nenin 33 pas paragrafit (8) shtohet paragraf i ri (9), si vijon:

“(9) Personi përgjegjës për llogari individuale është përgjegjës për udhëheqjen e drejtë dhe në kohë, arkivimin dhe ruajtjen e evidencës për llogari vullnetare individuale dhe profesionale të çdo anëtari dhe anëtari të pensionuar të fondit pensional vullnetar, në pajtim me dispozitat e këtij neni.”.

Neni 6

Në nenin 34 në paragrafin (1), pas fjalës “revizion” shtohen fjalët: “i udhëhequr nga revizori i brendshëm”.

Neni 7

Në nenin 34-a në paragrafin (1), pas fjalës “emëron” shtohen fjalët: “person përgjegjës për përlllogaritjen e tërheqjeve të programuara përkatësisht”.

#### Neni 8

Në nenin 39 paragrafi (1) në pikën x), nenin 48 paragrafi (5) në pikën i), neni 55 paragrafi (1) në pikën x), neni 79 paragrafi (5) në pikën i) fjalët: “do të jenë në vende udhëheqëse edhe persona tjerë të cilët” shlyhen:

#### Neni 9

Pas nenit 107 shtohet nen i ri 107-a, si vijon:

##### “Neni 107-a

(1) Personi përgjegjës për marketing është përgjegjës për reklamim të punës së shoqërisë që menaxhon me fondin pensional vullnetar dhe fondin pensional vullnetar me të cilin menaxhon dhe për informim lidhur me sigurimin pensional vullnetar me financim kapital, në pajtim me ligjin.

(2) Personi përgjegjës për kontroll të agjentëve është i obliguar të kryejë kontroll mbi aktivitetet e agjentëve të lidhur me anëtarësimin dhe transferimin e anëtarëve nga një fond pensional vullnetar në një tjetër dhe lidhjen e marrëveshjeve për pagesën e kompensimeve pensionale.”

#### Neni 10

Në nenin 130 në paragrafin (2), pas fjalëve: “këshilli drejtues” lidhëza “dhe” zëvendësohet me presje, ndërsa pas fjalëve: “këshilli drejtues” shtohen fjalët: “dhe person përgjegjës për vendime investuese.”

#### Neni 11

Në nenin 164 në paragrafin (1) fjalët: “nenet 165, 166, 167, 167-a, 168, 168-a, 169, 170 dhe 171” zëvendësohen me fjalët “neni 169”.

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4), si vijojnë:

“(3) Personat e autorizuar për kontroll për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 165, 166, 167, 168, 169, 171 dhe 172 të këtij ligji, janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t’i propozojë procedurë për barazim me lëshimin e urdhërpagesës për kundërvajtje para se të parashtrijë kërkesë për procedurën për kundërvajtje.

(4) Agjencia e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje nga paragrafi (3) i këtij neni.”

#### Neni 12

Në nenin 165 në paragrafin (1) fjalët: “40.000 euro” zëvendësohen me fjalët: “9.000 deri në 10.000 euro”.

Në paragrafët (2), (4), (6) dhe (8) fjalët: “shumë e dhjetëfishtë prej” zëvendësohen me fjalët: “shumë e dyfishtë nga maksimumi i gjobës”.

Në nenin 9 fjalët: “4.000 euro” zëvendësohen me fjalët: “400 deri 500 euro”.

Paragrafi (10) ndryshohet si vijon:

(10) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”

#### Neni 13

Neni 166 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 8.000 deri 9.000 euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare apo shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, nëse:

- 1) nuk miraton kodeks për menaxhim të mirë korporativ dhe nuk punon në pajtim me nenin 13 paragrafi (3) të këtij ligji,
- 2) nuk vendos mekanizma kontrollues efikas, nuk vendos procedura dhe nuk përcakton person në pajtim me nenin 30-b të këtij ligji,
- 3) i shfrytëzon mjetet e tij për dedikime të ndaluara me nenin 32 të këtij ligji,
- 4) nuk i përmbush kërkesat e parapara në nenin 33 paragrafët 1), (2), (3), (4), (5) dhe (6) të këtij ligji,
- 5) nuk themelon njësi organizative për revizion të brendshëm në pajtim me nenin 34 të këtij ligji,
- 6) nuk i respekton detyrimet e nenit 34-a paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij ligji,
- 7) nuk vendos aktivitete për menaxhim me rreziqet, nuk emëron person përgjegjës për menaxhim me rreziqet dhe nuk dorëzon raport në pajtim me nenin 34-b paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij ligji,
- 8) nuk emëron revizor të jashtëm të autorizuar me referenca të mira dhe nuk shpall ekstrakt nga raporti i reviduar financiar, me mendim të revizorit të autorizuar në pajtim me nenin 35 të këtij ligji,
- 9) vepron në kundërshtim me nenin 35-a të këtij ligji,
- 10) refuzon anëtarësim të personit i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 94 paragrafin (1) të këtij ligji,
- 11) nuk hap llogari vullnetare individuale dhe llogari profesionale në pajtim me nenin 95 paragrafin (1) të këtij ligji,
- 12) nuk i bart mjetet nga fondi ekzistues pensional në fondin e ardhshëm pensional në pajtim me nenin 97 paragrafin (1) të këtij ligji,
- 13) nuk i siguron të drejtat e anëtarit të fondit pensional i cili ka pushuar së paguari kontribute në fond para pensionimit në pajtim me nenin 99 të këtij ligji,
- 14) jep informata të gabuara dhe të pasakta për fondin vullnetar pensional, për skemën profesionale pensionale ose për shoqërinë e cila menaxhon me atë fond në kuptim të nenit 107 paragrafit (1) të këtij ligji,
- 15) jep deklarata ose parashikime për rezultatet e ardhshme investuese për fond vullnetar pensional në kuptim të nenit 107 paragrafit (2) të këtij ligji,
- 16) hapësitrat e shoqërisë dhe hapësitrat e bashkëpunëtorëve të tij afaristë për marketing nuk i përmbushin kushtet nga neni 108 paragrafi (1) i këtij ligji,
- 17) nuk lidh marrëveshje për kryerjen e punëve të marketingut të fondit vullnetar pensional me bashkëpunëtor afarist në pajtim me nenin 108 paragrafin (2) të këtij ligji,
- 18) lidh marrëveshje me person fizik pa ndërmjetësim të agjentit në kundërshtim me nenin 109 paragrafin (1) të këtij ligji,
- 19) zbaton procedura të marketingut të fondeve pensionale të ndaluara me nenin 112 të këtij ligji,
- 20) nuk i respekton kërkesat në lidhje me shpalljen e prospektit informativ të përmbajtura në nenin 113 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji,
- 21) nuk dorëzon prospekt informativ dhe statut të anëtarit dhe të anëtarit të pensionuar të fondit vullnetar pensional, nuk i jep në këqyrje personave në pajtim me nenin 113 paragrafin (4) të këtij ligji,
- 22) dorëzon të dhëna për anëtarët dhe për anëtarët e pensionuar në formë në kundërshtim me nenin 114 paragrafin (6) të këtij ligji,
- 23) nuk e përmbush detyrimin për informim të rregullt të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondit vullnetar pensional në pajtim me nenin 114 të këtij ligji,
- 24) nuk i dorëzon në Agjenci informatat e shënuara në nenin 116 paragrafin (1) të këtij ligji dhe në aktet e përcaktuara nga Agjencia,

25) nuk e njofton Agjencinë dhe të gjithë anëtarët dhe anëtarët e pensionuar të fondit pensional për çdo ndryshim të shumës së kompensimeve, në mënyrë dhe afate të parapara në nenin 119 të këtij ligji,

26) nuk e përcakton kontributin për fondin pensional me të cilin menaxhon në pajtim me nenin 127 të këtij ligji,

27) vepron në kundërshtim me kufizimet e parapara në nenin 135 të këtij ligji;

28) nuk ka dokument për strategji investuese me përmbajtje në pajtim me nenin 140 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji dhe aktet e përcaktuara nga Agjencia,

29) nuk e njofton Agjencinë kur dëshiron të prishë marrëveshjen për ruajtjen e pronës në pajtim me nenin 154 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

30) nuk vepron në pajtim me paragrafët dhe mendimet e paraqitura në aktet e Agjencisë.

(2) Gjobë deri në shumën e dyfishtë nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm pronësor më të madh për fondin pensional.

(3) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në shoqëri.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”

#### Neni 14

Neni 167 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 4.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale vullnetare ose shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, nëse:

1) nuk vepron për ndonjëherë nga kërkesat nga neni 28 paragrafi (3) i këtij ligji,

2) nuk përgatit plan vjetor për punë, raport për punën e tij dhe nuk i dorëzon në Agjenci në pajtim me nenin 34 paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji,

3) nëse nuk e dorëzon në Agjenci, në fotokopje ose në mediet e jashtme përkatëse, materialin e publikuar për marketing në afat prej tri ditësh pas publikimit të tij.

4) nuk dorëzon të dhëna dhe informata në agjenci në afatet e parapara me nenin 116 paragrafët (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8) dhe (9) të këtij ligji dhe

5) agjencinë nuk e njofton menjëherë për vlerën e mjeteve neto të fondit pensional vullnetar dhe vlerën e njësisë së kontabilitetit të fondit vullnetar në pajtim me nenin 126 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 4.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare, nëse:

- nuk vepron në pajtim me nenin 109 paragrafin (8) të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në shoqëri.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”

#### Neni 15

Neni 167-a shlyhet.

#### Neni 16

Në nenin 168 në paragrafin (1) fjalët: “40.000 euro” zëvendësohen me fjalët: “9.000 deri në 10.000 euro”.

Në paragrafin (1) pika 2 ndryshohet si vijon:

“nuk ndërmerr aktivitete për harmonizim me dispozitat nga neni 149 paragrafi (2) në periudhë jo më të gjatë se tre muaj nga dita kur ka pushuar t’i plotësojë disa prej kushteve në pajtim me nenin 149 paragrafin (4) të këtij ligji;

Në paragrafin (2) fjalët: “shumë e dhjetëfishtë prej“ zëvendësohen me fjalët: “shumë e dyfishtë nga maksimumi i gjobës”.

Në paragrafin (3) fjalët: “4.000 euro” zëvendësohen me fjalët: “400 deri 500 euro”.

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”

#### Neni 17

Neni 168-a shlyhet.

#### Neni 18

Neni 169 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 200 deri 250 euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, nëse:

1) si anëtar i Këshillit drejtues, të këshillit mbikëqyrës dhe person përgjegjës për: vendimet investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përlllogaritje të tërheqjeve të programuara nuk e plotëson detyrimin fiduciar nga neni 30-a paragrafi (1) i këtij ligji,

2) si person përgjegjës për llogari individuale nuk u përmbahet detyrimeve nga neni 33 paragrafi (9) i këtij ligji,

3) si aktuar nuk u përmbahet detyrimeve të parapara në nenin 34-a paragrafët (5), (6),(7) dhe (10) të këtij ligji,

4) si person përgjegjës për menaxhim me rreziqe nuk siguron analizë objektive të rreziqeve dhe nuk e këshillon në mënyrë të drejtë këshillin drejtues në pajtim me nenin 34-b paragrafin (3) të këtij ligji,

5) si agjent i shoqërisë nuk u përmbahet detyrimeve dhe kufizimeve të parapara në nenin 107 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji,

6) si person përgjegjës i marketingut nuk u përmbahet detyrimeve nga neni 107-a paragrafi (1) i këtij ligji,

7) si person përgjegjës për kontroll të agjentëve nuk u përmbahet detyrimeve nga neni 107 paragrafi (2) i këtij ligji,

8) si agjent i shoqërisë nuk u përmbahet detyrimeve dhe kufizimeve të parapara në nenin 109 paragrafët (2) dhe (4) të këtij ligji,

9) si person fizik nuk u përmbahet detyrimeve dhe kufizimeve të parapara në nenin 109 paragrafët (3) dhe (6) të këtij ligji dhe

10) si agjent i shoqërisë realizon kontakte në kundërshtim me nenin 110 të këtij ligji.”

#### Neni 19

Neni 170 shlyhet.

#### Neni 20

Në nenin 171 në paragrafin (1) fjalët: “5.000 euro” zëvendësohen me fjalët: “4.000 deri në 5.000 euro”.

Në paragrafin (2) fjalët: “shumë e pesëfishtë prej“ zëvendësohen me fjalët: “shumë e dyfishtë nga maksimumi i gjobës”.

Në paragrafin (3) fjalët: “1.500 euro” zëvendësohen me fjalët: “300 deri 400 euro”.

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”

Neni 21

Në nenin 172 në paragrafin (1) fjalët: “20.000 euro” zëvendësohen me fjalët: “4.000 deri në 5.000 euro”.

Në paragrafin (2) fjalët: “2 000 euro” zëvendësohen me fjalët: “300 deri 400 euro”.

Neni 22

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.